VENDIM
Nr. 624, datë 21.12.1999

PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË PALËS SHQIPTARE, PJESËMARRËSE NË FORCËN SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE.

(Ndryshuar me VKM nr. 701, datë 27.12.2001; nr. 544, datë 1.8.2003; nr. 140, datë 11.2.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 7496, datë 3.7.1991, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 12 të ligjit nr.8544, datë 4.11.1999 për ratifikimin e Marrëveshjes dhe Protokollit Shtesë "Për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore: me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. Mbi shpenzimet financiare të palës shqiptare për forcën shumëkombëshe të Europës Juglinodre

1. Ministria e Mbrojtjes të përballojë shpenzimet e palës shqiptare, pjesëmarrëse në strukturën e Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore për:

a) shpenzime kombëtare direkte, të përdorura për mbështetjen e forcave tona pjesëmarrëse në këtë forcë;

b) shpenzime administrative për buxhetin e përbashkët të Shtabit të Brigadës për veprime, operacionale e mirëmbajtje.

II. *Shfuqizuar.*

III.Efektet financiare nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 1999, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes për këtë vit, në shumën 4 170 mijë lekë.

IV.Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi dhe përfshirjen e efekteve financiare për vitet në vazhdim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta